



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 25 Janar 2022

Nr: 4

V E N D I M

P Ë R

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 5, DATË 20.11.2020, TË KOMISIONIT RREGULLATOR,
“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR”**

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

1. Në fund të pikës 1, të nenit 25, të vendimit nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:
“Për zgjedhjet e parakohshme dhe/ose të pjesshme, afati i ankimit 3 (tre) ditë, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, bëhet 24 (njëzet e katër) orë...”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO	Kryetar
Arens ÇELA	Anëtar
Dritan ÇAKA	Anëtar
Helga VUKAJ	Anëtar
Muharrem ÇAKAJ	Anëtar

